

Reaksionet e muslimanëve boshnjakë dhe shqiptarë në Zvicër ndaj diskursit islam*

Një studim i kryer brenda kornizës së Programit Nacional për Hulumtime „Bashkësitë fetare, shteti dhe shoqëria“ (NFP 58)

Raporti final

(Titulli i plotë origjinal: „Nichtchristliche Religionsgemeinschaft im öffentlichen Diskurs. Auswirkungen des Islam-Diskurses auf die Selbpräsentations- und Kommunikationsstrategien bosnischer und albanischer Muslime in der Schweizer Öffentlichkeit)

Lucern, 28 gusht 2010

Drejtues i projektit:

Dr. Samuel M. Behloul, Religionswissenschaftliches Seminar, Universiteti i Lucernit

Nga gjermanishtja:

Mr. Rejhan Neziri

* Titulli origjinal: „Reaktionen der bosnischen und albanischen Muslime in der Schweiz auf den Islam-Diskurs“.

1. Hyrje në problematikë dhe në trajtimin e çështjes

Projekti hulumtues studion dhe analizon diskursin islam të periudhës së pas 11 shtatorit 2001 lidhur me rolin e tij konstitutiv për strategji të reja vetëprezantuese dhe komunikuese të bashkësive diasporale muslimane në Zvicër. Pikënisja e analizës qëndron në pyetjen, sa dhe si ka ndikuar tematizimi dhe problematizimi i Islamit, që pas 11 shtatorit 2001 është vënë në qendër të debateve publike dhe që praktikisht i ka kapluar të gjitha fushat e shoqërisë (politikë, edukim, imigrim, integrim, siguri), mbi strategjitë e veprimit të grupeve muslimane nga aspekti i vetëprezantimit të tyre në publikun zviceran dhe i komunikimit të tyre me publikun më të gjerë. Në debatet publike Islami nuk shihet vetëm si një fe që nuk përputhet me kornizën normative-juridike të shoqërisë perëndimore, por për më tepër, si bashkësia fetare më e madhe jo-krishtere në shoqëritë evro-perëndimore, ai perceptohet dhe interpretohet edhe si kërcënim për identitetin fetar-kulturor të Evropës po edhe si rrezik për ruajtjen e kornizës normative-juridike, respektivisht ruajtjen dhe kultivimin e ndarjes së fesë nga shteti, që është fituar me një luftë të mundimshme në të kaluarën. Kjo pamje mbi Islamit që dominon në medie dhe në shumë debate politike, në fakt ka të bëjë vetëm me një pjesë të vogël të muslimanëve. Shumica e muslimanëve ndjehen të detyruar të reagojnë dhe të marrin qëndrim publik ndaj kësaj pamjeje të krijuar për ta si një kolektiv fetar.

2. Konceptimi dhe realizimi i projektit

Bazën empirike të këtij projekti e përbëjnë muslimanët boshnjakë dhe shqipfolës që jetojnë në Zvicër. Të dhënat e mbledhura nga njëra anë përmes intervistave me ekspertë, bisedave në grupe dhe vrojtimit të pjesëmarrësve (dokumentime fotografike dhe filmike) dhe nga ana tjetër përmes analizës së shfaqjeve në internet të grupeve të hulumtuara dhe të gazetave që qarkullojnë nëpër shoqatat e tyre, janë analizuar dhe vlerësuar në mënyrë krahasuese. Në fillim të realizimit të projektit, përmes një serie ligjëratah publike në universitetin e Lucernit (semestri pranveror 2008) me ligjërues mysafirë nga Fakulteti i Shkencave Islame pranë Universitetit të Sarajevës, është diskutuar zhvillimi aktual i Islamit në Bosnjë dhe është krahasuar pastaj me tendencat zhvilluese të diasporës boshnjake-muslimane në Zvicër. Rezultatet e analizës janë prezantuar në konferenca e takime kombëtare dhe ndërkombëtare dhe janë përgatitur në përmbledhje të veçanta për publikim.

Rezultatet

1. Problemi i perceptimit

Që nga sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 imigrantet dhe imigrantët me origjinë nga shoqëritë muslimane si dhe pasardhësit e tyre këtu në Zvicër – për dallim prej grupeve të tjera imigrante – janë reduktuar në përkatësinë e tyre fetare islame. Pjesa dërmuese e të intervistuarve, veçanërisht të rinjtë, e konsiderojnë këtë si ngacmuese. Në jetën e tyre të përditshme ata dëshirojnë të perceptohen në radhë të parë si qytetarë normalë.

1.1. Përderisa në debatet publike rreth Islamit dhe muslimanëve pothuajse mbizotëron një konsensus, se prania e Islamit, bazuar në të dhënat statistikore, paraqet një sfidë plotësisht të re shoqërore-politike për Zvicrën si bashkësi fetare më e fuqishme jo-krishtere, nga ana tjetër shumica e të intervistuarve brenda mjediseve të xhamive të analizuar konstatojnë njëzëshëm

se shumica prej tyre jetojnë në paqe qe një kohë të gjatë në Zvicër dhe se debatet publike rreth muslimanëve dhe aftësisë së tyre për t'u integruar, të intensifikuara dukshëm pas 11 shtatorit, shikohen si një novacion i papritur dhe jo rrallëherë edhe ngacmues.

1.2. Kërkesa e shoqërisë shumicë zvicerane drejtuar muslimanëve për t'u distancuar qartë nga veprimet dhe qëndrimet e islamistëve dhe për ta dëshmuar lojalitetin normativ-juridik ndaj shoqërisë zvicerane, në të shumtën e rasteve shihet jo vetëm si e tepruar („Çfarë kemi të bëjmë ne boshnjakët me këtë?“), porse para së gjithash edhe si shprehje e besimit të mangët ndaj muslimanëve. Një argument shpesh i vënë në pah me rastin e zhvillimit të intervistave (intervistat me ekspertë dhe në bisedat grupore).

1.3. Në bisedat intervistuese që janë zhvilluar pas referendumit mbi minaret, del në plan të parë qëndrimi se rezultati i referendumit është një dëshmi se iniciativa (për ndalimin e minareve) ka qenë një pretext i thjeshtë për ta margjinalizuar Islamin dhe muslimanët. Pa dyshim, me këtë kanë shkuar huq të gjitha dëshmitë e lojalitetit të dhëna më parë nga ana e muslimanëve.

2. Strategjitë e ndryshme publike dhe reaksionet ndaj diskursit islam

Fakti se muslimanët në Zvicër përbëjnë një bashkësi heterogjene nga aspekti gjuhësor dhe kulturor, manifestohet edhe në mënyrën se si këto bashkësi reagojnë ndaj tematizimit publik të Islamit.

2.1. Hulumtimi krahasimtar i kryer në bashkësitë islame shqiptare dhe boshnjake dëshmon fushën e tensionit brenda-musliman, që në debatet mbi Islamin thuhet nuk është marrë parasysh, lidhur me pozicionimin midis rolit të përkatësisë fetare, shpesh të mbitheksuar në këto debate, nga njëra anë, dhe trashëgimisë kulturore etno-specifike tanimë ekzistuese te secila bashkësi si dhe me mënyrën e qasjes së tyre ndaj kësaj trashëgimie nga ana tjetër.

2.2. Strategjitë publike të muslimanëve shqiptarë në përgjithësi shquhen me tendencën për „shkulturalizimin“ e Islamit. Pra, ata bëjnë një dallim të vetëdijshëm midis „Islamit të vërtetë“ nga njëra anë dhe traditës/mentalitetit/zakoneve/adeteve nga ana tjetër. Intervistat si dhe analiza e ueb faqeve të disa shoqatave tregojnë tendencën për mbulimin e imazhit negativ të të huajve shqiptarë, që mbizotëron përgjithësisht në publik, me anë të fesë. Edhe pse disa persona të intervistuar pa kurrfarë ndrojtje e theksojnë rëndësinë e origjinës së tyre si muslimanë shqiptarë (d.m.th. evropianë), megjithëkëtë marrë në përgjithësi vërehet tendenca që në vend të perceptimit negativ të prejardhjes („Albaner/shqiptar“) të vihet përkatësia fetare e tyre. Të pyetur për shembull për problemet me të rinjtë shqiptarë, për martesat e dhunshme ose për gjakmarrjen, imamët shqiptarë i referohen potencialit sqarues dhe integrujes të Islamit (Shënim nga një intervistë: *“asnjë i ri i shoqatës sonë nuk ka probleme me policinë, me prindërit ose me autoritetet shkollore”*).

2.3. Në strategjitë publike të shqiptarëve në të njëjtën kohë manifestohet edhe fakti se vetë ata, për sa i përket prejardhjes së tyre – përkundër mendimit shumë të përhapur – përbëjnë një grup heterogjen. Shqiptarët muslimanë në Zvicër vijnë nga tri vise të ndryshme të ish-Jugosllavisë (Kosova, Maqedonia dhe Serbia), të cilat në ndërkohë kanë fituar pavarësinë shtetërore të tyre. Në përputhje me këtë heterogjenitet, nuk shihet që komunitetet shqiptare të kenë përcaktuar ndonjë strategji të përbashkët lidhur me shfaqjen në publik dhe në ngritjen e kontakteve me shoqërinë shumicë (d.m.th. në nivel të një lidhjeje kulmore sipas përkatësisë gjuhësore në formë të një *Shoqate/Bashkësie Shqiptare Islame*). Kështu mund të vërehet se disa xhami shqiptare, duke u mbështetur në iniciativën private të udhëheqësve të xhamisë ose të imamit, kanë krijuar kontakte shumë të mira me autoritetet vendore në nivel kantonial, me kishat, me shkollat e me institucionet e tjera dhe se përfaqësuesit e tyre janë vazhdimisht prezent në medie dhe se marrin pjesë aktive në manifestimet e ndryshme me karakter publik, ndërkaq disa xhami të tjera

(madhësia dhe numri i anëtarëve të xhamisë këtu nuk është vendimtar) mbeten të kufizuara vetëm me shërbimet ndaj anëtarëve të tyre.

2.4. Analiza e të dhënave të mbledhura nga xhamitë boshnjake në Zvicër, tregon se duhen pasur parasysh dy aspekte, kur është në pyetje mënyra se si boshnjakët ndërfiten në diskursin islam këtu në Zvicër dhe si ata shfaqen në publik me vetëkuptueshmërinë e tyre:

a) *Shkalla e lartë e organizimit.* Me 19 xhamitë e tyre të regjistruara për momentin boshnjakët përbëjnë atë që quhet *“Bashkësia Islame e Boshnjakëve në Zvicër” (Islamische Gemeinschaft der Bosniaken in der Schweiz)*. Autoritetin më të lartë fetar dhe administrativ të muslimanëve boshnjakë e përfaqëson i ashtuquajtur *Rijaset* (Kryesi) me seli në Sarajevë. Në krye të tij qëndron kryetari i kolegjiut të dijetarëve ose *reis ul-ulema*, ashtu siç quhet titulli zyrtar i tij. Në vitin 1996, me propozim të kryetarit aktual Mustafa Ceriq, brendapërbrenda *Rijasetit* themelohet zyra për diasporën boshnjake. Kjo zyrë mban kontakte të ngushta me mbi 200 shoqata fetare-kulturore të muslimanëve boshnjakë (boshnjakisht: *Džemat*, d.m.th. kongregacion, shoqatë) në Evropë, SHBA, Kanada dhe Australi. Të gjithë imamët e angazhuar në diasporë, me kërkesë të shoqatës gjegjëse në diasporë, caktohen dhe dërgohen për detyrë atje nga ana e *Rijasetit*. Për të gjitha xhamitë në diasporë *Rijaseti* ka përcaktuar statutin detyrues (të cilit i janë referuar boshnjakët pothuajse në secilin takim, madje në disa shoqata të xhamive ai qëndron i varur në mur), në të cilin, ndër të tjera, definohen edhe synimet e shoqatave të xhamive boshnjake në diasporë: *“Synimi i džematit qëndron në ruajtjen dhe avancimin e jetës fetare të muslimanëve në frymën e mësimëve islame. Për këtë arsye ai kërkon prej besimtarëve që të angazhohen në mënyrë vullnetare për synime humanitare dhe të japin kontributin e tyre qenësor për një bashkëjetesë konstruktive me bashkësitë e tjera fetare”*.

b) *Imazhi pozitiv në publik.* Përderisa debatet publike mbi Islamin japin një pamje negative rreth Islamit, me ç’rast dominon një pabesi paushalle ndaj muslimanëve, muslimanët nga Bosnja dhe Hercegovina në kontekst të këtij debati shihen si evropianë dhe jo-problematikë nga aspekti i ushtrimit fetar dhe i aftësisë integruese të tyre. Përveç kësaj, në diskursin shkencor po edhe në atë politik, gjithnjë e më shumë flitet për karakterin model të Islamit boshnjak për Islamin e ardhshëm evropian, edhe atë, si në aspektin e strukturave organizative, po ashtu edhe në aspektin e përvojës jetësore të kushtëzuar historikisht në rrethana të shumëllojshmërisë fetare dhe konfesionale si dhe të rendit shoqëror shekullar.

2.5. Duke pasur parasysh këto dy aspekte të përmendura, pala boshnjake zhvillon bisedën lidhur me çështjet e diskutuara në diskursin publik mbi Islamin rreth aftësisë së integritetit të Islamit në rendin juridik dhe në atë të vlerave zvicerane, me një ton pothuajse absurditeti duke theksuar se boshnjakët tanimë me shekuj të tërë jetojnë krahas krahas me bashkësitë e tjera fetare (Shënime nga intervistat: *“Unë madje e di se çfarë shije kanë vezët e Pashkëve”* ose *“Sulltani ynë selinë nuk e ka në orient/lindje, porse në Bruksel”*) dhe se janë mësuar që, edhe nën kushte jo të kënaqshme politike (Jugosllavia komuniste dhe lufta e viteve 1990), të organizohen e ta ruajnë fetarinë e tyre specifike. Nga ana e kryetarëve dhe imamëve të xhamive që janë intervistuar, vërehet thuhet një automatizëm, kur ata u referohen a) shoqatave të xhamive boshnjake në diasporë që kanë një vetëkuptueshmëri statutare të përcaktuar si dhe b) përvojave historike-kulturore të muslimanëve boshnjakë. Kjo vetëkuptueshmëri, respektivisht imazhi publik mbisundues rreth Islamit boshnjak, mund të shihet edhe si një arsye se përse muslimanët boshnjakë, në krahasim të drejtpërdrejtë me ata shqiptarë, janë më pak të pranishëm në debatet publike rreth Islamit dhe muslimanëve dhe se në rast të ndonjë paraqitjeje publike ata i japin përparësi prezantimit të “Islamit boshnjak”.

2.6. Asimetria që mund të vërehet në një perspektivë krahasimtare midis shqiptarëve dhe boshnjakëve kur është në pyetje intensiteti i përzjerjes dhe pjesëmarrjes aktive të tyre në diskursin publik rreth Islamit që zhvillohet në Zvicër, theksohet edhe në rrafshin e prezencës në internet. Kështu, në ueb faqet e xhamive shqiptare, që kryesisht janë dygjuhëshe (shqip/gjermanisht), nga ana e ekspertëve të tyre (imamëve) tematizohen dhe sqarohen nga aspekti islam tema si martesë e dhunshme, raporti gjinor, ekstremizmi fetar etj., kurse nëpër forume të ndryshme interneti diskutohen të njëjtat edhe në mesin e vizitorëve muslimanë dhe jo-muslimanë (kryesisht në mesin e të rinjve). Në këto forume, të rinjtë ftohen nga imamët e tyre

që të kontribuojnë në mënyrë aktive në përmirësimin e imazhit të të rinjve shqiptarë që jetojnë në Zvicër. Në ueb faqet e boshnjakëve, që deri më sot mbahen vetëm në gjuhën boshnjake, temave të këtilla po thuajse nuk u kushtohet kujdes fare. Këtu dominojnë temat që janë relevante për bashkësinë (situata politike në Bosnje, pushimet në Bosnje etj.) dhe interesante për të rinjtë (muzika, sporti, argëtimi etj.).

2.7. Marrë në përgjithësi, një analizë krahasimtare e pozicionimit të shqiptarëve dhe të boshnjakëve brenda diskursit islam në Zvicër, tregon se shqiptarët e theksojnë më shumë potencialin sqarues të fesë përkundër zakoneve e traditave të tyre. Proporcionalisht me këtë edhe shfaqjet publike të tyre karakterizohen mjaft shumë nga semantika e një Islami “të vërtetë” e “autentik”. Për boshnjakët së këndejmi në plan të parë qëndron karakteri specifik evropian i Islamit boshnjak. Kultura e tyre këtu shërben në një farë mase si garanci kundër ekstremizmit fetar. Deklaratat e boshnjakëve lidhur me dukuritë e tematizuara në diskursin publik mbi Islamin, siç janë martesat e dhunshme, raportet gjinore dhe ekstremizmi fetar, kufizohen të anketuarit shpeshherë me përkujtimin e thjeshtë se për Islamin boshnjak ato janë të huaja dhe se kanë të bëjnë me grupet tjera muslimane. Përkundër konteksteve të ndryshme të arsytimit të të dyja grupeve, të dyja këto strategji diskursi kanë një të përbashkët: në imazhin e tyre të etabluar mbi Islamin manifestohet imazhi mbi Islamin i krijuar në diskursin publik të shoqërisë shumicë dhe para së gjithash manifestohen pritjet bazë dhe presioni normativ.

3. Një raport i ri komunikimi

Përkundër dominimit të një imazhi negativ rreth Islamit nëpër debatet publike dhe përkundër dyshimit shpesh të përsëritshëm ndaj aftësisë integruese të tij në shoqërinë zvicerane, diskursi islam në periudhën pas 11 shtatorit ka shkaktuar edhe një intensifikim të kontakteve si ndër grupet e ndryshme muslimane të diasporës ashtu edhe ndër aktorët relevantë të shoqërisë shumicë të Zvicrës.

3.1. Fazat e shtrirjes së xhamive në vitet e fundit, të përshkruara nga ana e udhëheqësve të shoqatave islame, kur është në pyetje shërbimi që e bëjnë këto xhami, dëshmojnë për rreshtimin definitiv të bashkësive diasporale të shqiptarëve dhe të boshnjakëve në vendosjen definitive në Zvicër. Regjistrimi sasior dhe cilësor nga ana e këtij studimi i aktiviteteve që organizohen brenda xhamive shqiptare dhe boshnjake dëshmojnë nga ana tjetër një cilësi të re të raportit dhe të komunikimit me shoqërinë shumicë zvicerane në kohën e pas 11 shtatorit. Nëse shumica e kontakteve para 11 shtatorit kanë qenë të kufizuara kryesisht në marrëdhëniet e punës ose në autoritetet lokale, për shembull për shkak të negociatave për lejimin e hapjes së lokaliteteve tubuese, tani bëhet fjalë gjithnjë e më shumë për vënien e kontakteve me mbarë shoqërinë (autoritetet, kishat e vendit, institucionet arsimore dhe kulturore, klubet sportive etj.).

3.2. Edhe pse personat dhe grupet e intervistuar nga mjedisi i xhamive shqiptare dhe boshnjake tematizimin e intensifikuar të Islamit nga njëra anë e shohin si të tepruar dhe shpesh të papërshtatshëm madje edhe si jo relevant për grupin e tyre (p.sh. boshnjakët), nga ana tjetër kur janë në pyetje tubimet publike, viteve të fundit gjithnjë në rritje e sipër, të iniciuara dhe të organizuara nga ana e aktorëve muslimanë (si p.sh. ditët e dyerve të hapura të xhamive, tubimet dhe diskutimet publike rreth Islamit, rastet e lutjeve ndërfitare, organizimet sportive, pjesëmarrja gjithnjë në rritje e imamëve në edukimin e mëtejshëm për të fituar kompetencat ndërkulturore, pjesëmarrja e grupeve të të rinjve muslimanë në “Midnight Sport”-et lokale etj.), jepet të kuptohet se diskursi islam ka krijuar një intensifikim dhe thellim të kontakteve së pari midis grupeve brenda-muslimane në diasporë dhe së dyti midis këtyre dhe popullatës shumicë jo-muslimane. Disa përfaqësuesve të xhamive shqiptare dhe boshnjake kjo madje u ka ofruar mundësinë e një lloj avancimi social, me ç’rast këta kërkohen jo vetëm si bashkëbisedues për medie dhe autoritete të ndryshme, porse edhe si referentë pranë institucioneve arsimore-educative.

3.3. Në mesin e personave të intervistuar sundon pajtueshmëria se muslimanët – qoftë në nivel të organizatave ombrellë nacionale, qoftë brenda xhamive të tyre etnike – duhet të angazhohen në mënyrë më intensive për të shembur mosbesimin që ekziston në mesin e popullatës shumicë ndaj muslimanëve. Përderisa disa persona të intervistuar, duke u mbështetur në rezultatet e referendumit për ndalimin e minareve, e shprehin dyshimin e tyre për efektin pozitiv të një angazhimi të tillë, të tjerët në mënyrë thujse vetëkritike theksojnë se bashkësitë muslimane të këtushme është dashur që gjatë fushatës së referendumit mbi minaret të kishin qenë më të bashkuara në kufijtë e tyre kulturorë, në mënyrë që ta kumtonin më qartë pozicionin e tyre para publikut zviceran.

4. Rekomandimet për politikën

Edhe pse koniunktura e vazhdueshme e tematizimit mediatik dhe politik të Islamit dhe muslimanëve, që vjen si jehonë e ngjarjeve të 11 shtatorit, mundëson hapësira dhe nivele të reja komunikimi midis grupeve diasporale të muslimanëve nga njëra anë dhe pastaj edhe me shoqërinë shumicë zvicerane nga ana tjetër, prapëseprapë për rrjedhojë duhet të nxjerrim në pah disa fusha problematike të këtij diskursi të konstatuara nga studimi në fjalë si dhe të deduktojmë rekomandimet konkrete nga e njëjta.

4.1. Problematika e asimetrisë në diskursin aktual mbi Islamin

Në arenën aktuale të diskursit mbi Islamin dhe muslimanët, bashkësitë diasporale të muslimanëve paraqesin një aktor, i cili në nivel të publikut shoqëror shumë pak aktiv është në debatet lidhur me pozicionimin dhe rolin publik të ardhshëm të Islamit në Zvicër. Nën trysninë e justifikimit dhe pranimit nga ana e shoqërisë shumicë, muslimanët kufizohen kryesisht në theksimin statutar të vetëkuptueshmërive normative, në vend që me propozimet dhe vlerat e tyre të marrin pjesë në ndërtimin spontan të mendimit dhe vullnetit të anëtarëve të një shoqërie politike demokratike në drejtim të rregullimit të çështjeve publike. Rezultati i referendumit të minareve si dhe diskutimet gjithnjë në rritje rreth *burkës* dhe *shamisë* duket se do ta përforcojnë akoma më shumë këtë asimetri që është karakteristike për diskursin islam. Pothuajse nuk zhvillohet një dialog i hapur midis partnerëve të njëjtë. Për më tepër, nxirren ndalesa (referendumi për minaret), diskutohen dhe parashikohen ndalesa të reja (burka, shamia). Këtu ekziston rreziku që debatet e nevojshme publike rreth pozicionimit të ardhshëm të Islamit, si bashkësia fetare më e fuqishme jo-krishtere në Zvicër, të shkrihen në një diskurs anti-musliman. Për politikën këtu lind detyra e rëndësishme që muslimanët t'i perceptojë më fuqishëm si bashkëbisedues të vet me idetë, propozimet, vlerat (Konzervatizmi i vlerave të shumë përfaqësuesve të muslimanëve nuk duhet të interpretohet si radikalizëm dhe rrezik) po edhe me problemet e tyre dhe t'u lejojë atyre të marrin pjesë në një dialog publik rreth temave relevante politike dhe fushave të tjera të fërkimit në një shoqëri multifetare dhe multikulturore.

4.2. Problematika e mbitheksimit të përkatësisë fetare

Si një pikë e mëtejme problematike e diskursit aktual mbi Islamin është perceptimi thujse i papërrjashtueshëm i imigrantëve që vijnë nga shoqëritë me shumicë muslimane sipas kriterit të përkatësisë së tyre fetare. Në këtë perceptim theksohet në mënyrë të qartë se shoqëria shumicë e pranon faktin se “të huajt” ose “gastarbeiterat” janë bërë dukuri e qëndrueshme në shoqërinë zvicerane. Shumë muslimanë (pavarësisht shkallës së fetarisë së tyre dhe intensitetit të ushtrimit të fesë) mbitheksimin e përkatësisë së tyre fetare (para së gjithash në debatet politike) e shohin si të vetmen shenjë dalluese me çka ata karakterizohen ose si të asimilueshëm ose si “të huaj” të dyshimtë, si të njëanshëm dhe në njëfarë mase edhe si të stigmatizuar. Edhe pse në debatet publike rreth Islamit në ndërkohë thujse rregullisht vihet në pah heterogjeniteti i prejardhjes dhe i gjuhës së muslimanëve që jetojnë në Zvicër, në diskutimin politik lidhur me integrimin e muslimanëve të Zvicrës duhen marrë parasysh nga njëra anë edhe gama e gjerë e trajtimit individual (shpesh përtej dogmave fetare, urdhrave e ndalesave) të trashëgimisë fetare-

kulturore të vendit nga vijnë ata si dhe nga ana tjetër e trajtimit të determinanteve socio-kulturore të shoqërisë shumicë. Ajo çka shpesh theksohet për jo-muslimanët kur është në pyetje feja, e njëjta vlen edhe për muslimanët në Zvicër: secili një rast i veçantë!

4.3. Problematika e pritjeve lidhur me strukturat organizative

Shpesh nëpër debatet publike mbi Islamin në Zvicër thuhet se muslimanët këtu na qenkan dobët të organizuar. Nëse i shikojmë bashkësitë muslimane diasporale nga perspektiva e strukturës organizative të të dy kishave vendase, atëherë mund fillimisht të themi se ashtu është. Mirëpo nëse kihet parasysh fakti se shumica e muslimanëve të Zvicrës janë njerëz me prejardhje të huaj, atëherë rezulton një pamje më e plotë e strukturave të tyre organizative dhe e ofertave të shumëfishta të bashkësive të tyre, se ata në nivel lokal janë shumë mirë të organizuar dhe se i mbulojnë shumë mirë nevojat dhe kërkesat e komunitetit të tyre.

Në të vërtetë është e kuptueshme nëse nga ana e politikës pritet një shkallë më e qëndrueshme organizimi të muslimanëve në nivel supranacional. Për kontaktet e ardhshme me bashkësitë muslimane si dhe për pritjet lidhur me organizimin e tyre këtu në Zvicër duhet të kihen parasysh këto katër aspekte:

- a) Islami nuk njihet struktura hierarkike organizative të llojit të kishave. Pa dyshim se mund të pritet që bashkësitë diasporale muslimane do të (duhet të) zhvillojnë struktura organizative sipas kushteve socio-politike të veçanta për këtu në Zvicër, edhe pse ndofta të reja e të panjohura në vendlindjet e tyre, mirëpo proceset e këtilla do të marrin më shumë kohë se sa që mendohet zakonisht. Tekefundit kjo do të varet edhe nga intensiteti i tematizimit, respektivisht problematizimit të Islamit në vitet e ardhshme.
- b) Fakti se shumica e muslimanëve këtu në Zvicër janë me prejardhje të huaj, gjen shprehje edhe në formën dhe mënyrën se si ata organizohen. Përderisa muslimanët i themelojnë bashkësitë e tyre sipas standardeve gjuhësore dhe kulturore të vendeve prej nga vijnë, me këtë ata e ndjekin një “model imigrantësh” të përgjithshëm. Procese të njëjta kanë mund në të kaluarën po mund edhe sot e kësaj dite të vërehen edhe te grupet e imigrantëve të tjerë jo-muslimanë në Zvicër, qoftë këta të jenë italianët dhe kroatët katolikë, qoftë të jenë vietnamezët budistë apo tamilët hinduistë. Si te këta ashtu edhe te muslimanët vërehet qartë lidhja e fortë e tyre me vendet e prejardhjes. Në këtë aspekt me siguri nuk do të ndryshojnë shumë gjërat edhe në vitet, nëse jo edhe në dekadat, e ardhshme, sidomos nëse e kemi parasysh faktin se për shembull italianët që kanë ardhur në Zvicër qysh para pesëdhjetë vitesh akoma i mbajnë misionet e tyre katolike dhe nuk inkuadrohen në strukturat e ndonjërisë prej kishave të vendit.
- c) Shumë lokalitete të xhamive (para së gjithash te boshnjakët, pjesërisht edhe te shqiptarët) janë blerë dhe për rikonstruktimin e tyre përgjatë viteve janë investuar shumë para. Shpesh këto bashkësi vetëm formalisht janë të anëtarësuar në ndonjë shoqatë supranacionale dhe sot e kësaj dite, nga aspekti i nevojave të tyre etno-specifike dhe strategjive të tyre publike, ato e ndiejnë veten shumë pak ose vetëm kushtimisht të përfaqësuar nga reprezentativët e këtyre shoqatave ombrellë. Prioritetin financiar dhe kohor ata më së shumti ia kushtojnë aktiviteteve brenda komunitetit të tyre etno-specifik.
- d) Pikërisht nga aspekti i fushave të tensionit e të mosmarrëveshjeve që deri më tani kanë qenë të izoluarat e që në të ardhmen mund edhe të shtohen (si bartja e shamisë në shkollë, lirimi nga orët e notit, pjesëmarrja në kampet e klasës e shumë të tjera) në kontekst me pjesëtarët e besimit islam, me rëndësi është të krijohen lidhje me bashkëbisedues të besueshëm brenda secilës bashkësi veç e veç. Në raste të konflikteve të kushtëzuara nga tradita e zakonet këta ndikojnë si ndërmjetës më efektivë sesa përfaqësuesit e organizatave ombrellë, të eksponuar nga ana e medieve.